



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.195

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1532, datë 19.11.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës	10649
Vendim i KM nr.1533, datë 19.11.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Peshkopi, të qarkut të Dibrës	10649
Vendim i KM nr.1535, datë 26.11.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar	10650
Vendim i KM nr.1570, datë 3.12.2008	Për dhënie fondi ndihme partisë “Lidhja Demokristiane e Shqipërisë (LDK)”	10651
Vendim i KM nr.1571, datë 9.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga ministria e shëndetësisë, qendra spitalore universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe disa institucione, në varësi të kësaj ministrie, si autoritete kontraktore	10651
Vendim i KM nr.1576, datë 17.10.2008	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë	10653
Vendim i KM nr.1580, datë 3.12.2008	Për miratimin e disenjos përfundimtare të dokumenteve të identitetit: letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës elektronike.....	10654

Vendim i KM nr.1581, datë 3.12.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimit të shoqërive “Euron” sh.p.k, “Kadria” sh.p.k dhe “Teuta Konstruksion” sh.p.k, për ndërtimin e hidrocentralit “Orgjost i ri”, “Bele 1”, “Bele 2”, “Topojan 1” e “Topojan 2” 10655
Vendim i KM nr.1582, datë 26.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, bashkitë, komunat dhe ujësjetllës sha-të, si autoritete kontraktore..... 10655
Vendim i KM nr.1584, datë 3.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit, për objektet e investimeve, të grantit konkurrues, në shëndetësi, për vitin 2008 ... 10661
Vendim i KM nr.1586, datë 3.12.2008	Për transferim fondesh në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës 10663
Vendim i KM nr.1587, datë 3.12.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” 10663
Vendim i KM nr.1588, datë 3.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga ALUIZNI, drejtoria qendrore dhe drejtoria rajonale e qarkut të shkodrës, si autoritete kontraktore 10664
Vendim i KM nr.1591, datë 3.12.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.1472, datë 12.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet, në varësi të saj, si autoritete kontraktore” 10665
Vendim i KM nr.1592, datë 3.12.2008	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë 10665
Vendim i KM nr.1595, datë 3.12.2008	Për një shtesë në vendimin nr.1292, datë 24.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit” 10666
Vendim i KM nr.1596, datë 26.11.2008	Për kryerje pagesash, në formë kontributi, në fondin e përbashkët të NATO-s 10668
Vendim i KM nr.1599, datë 19.11.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e atasheve ushtarakë të forcave të armatosura, të ushtarakëve, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë, pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare” 10668
Vendim i KM nr.1602, datë 10.12.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, në pronësi të 4 familjeve të fshtrave Zall-Mner dhe Bulçesh, të prekura nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës..... 10669

Vendim i KM nr.1603, datë 10.12.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gorë, të qarkut të Korçës	10670
Vendim i KM nr.1604, datë 10.12.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Moglicë, të qarkut të Korçës	10671
Vendim i KM nr.1609, datë 10.12.2008	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe degën e doganës, Shkodër, si autoritete kontraktore	10672
Vendim i KM nr.1610, datë 10.12.2008	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore të investimeve, për drejtoritë rajonale të rrugëve, si autoritete kontraktore	10673
Vendim i KM nr.1611, datë 10.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Akademia e Shkencave, si autoritet kontraktor	10674
Vendim i KM nr.1612, datë 10.10.2008	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2007, për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korça IV”	10675
Vendim i KM nr.1613, datë 10.12.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, me kohë të plotë, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në vitin akademik 2008-2009.....	10677
Vendim i KM nr.1614, datë 10.12.2008	Për lejimin e kalimit tranzit të katër autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	10678
Vendim i KM nr.1615, datë 10.12.2008	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Drejtësisë, të objektit “Shtëpia e ushtarakëve, Pogradec”, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar ...	10679
Vendim i KM nr.1616, datë 10.12.2008	Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të komisionit për vlerësimin e masave për importet	10681
Vendim i KM nr.1674, datë 24.12.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH-sha-ja”.....	10684
Vendim i KM nr.1695, datë 24.12.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.....	10686

VENDIM
Nr.1532, datë 19.11.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Korçë të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 965 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1533, datë 19.11.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË PESHKOPI, TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Peshkopi të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1445 (një mijë e katërqind e dyzet e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Peshkopisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

Bashkia Peshkopi

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4,7-35	Prona që përdoren për realizimin e	Në pronësi

	programeve arsimore	
59	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
64-84,86-91	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
152-154	Varreza publike	Në pronësi
98	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	
141-143,155-172,188,189,196,201, 202,242-248,363,592-662,666,828	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
151,173-187,190-195,197-200,203-241,249-362,364-591,746,752,755,1114-1333	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
148-150,668,673-675,677,721,732-753,755-762,772777,819,820,822,823,826-828,839,840,842,878-884,909,910,1432	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
979-994	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (prona të bujqësisë).	Në pronësi
127,132,136,137,139,140	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
911-978	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
1424-1431,1433-1445	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.1535, datë 26.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2003 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqen pasuritë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Pasuritë e mësipërme transferohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E OBJEKTEVE TË CILAVE U HIQET E DREJTA E PRONËSISË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1. Metalike Tirana, Laprakë Tiranë | sipërfaqe prej 13 000 m ² |
| 2. Metalike Tirana, Tiranë (reparti i orëve) | sipërfaqe prej 418 m ² |

3. Ofiçina e automjeteve, Tiranë	sipërfaqe prej 14 502 m ²
4. Uzina e pjesëve të ndërrimit të automjeteve, Tiranë	sipërfaqe prej 15 000 m ²
5. Uzina e remontit të makinave metalprerëse, Tiranë	sipërfaqe prej 17 850 m ²
6. Uzina mekanike, Tiranë	sipërfaqe prej 10 623 m ²
7. Rërë shtufi, Tiranë	sipërfaqe prej 11 863 m ²
8. Parku i transportit, Tiranë	sipërfaqe prej 33 771 m ²

VENDIM
Nr.1570, datë 3.12.2008

PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË “LIDHJA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË (LDK)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Lidhja Demokristiane e Shqipërisë (LDK)” t’i jepet një fond, prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1571, datë 9.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË, QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, DHE DISA INSTITUCIONE, NË VARËSI TË KËSAJ MINISTRIE, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe të disa institucioneve, në varësi të kësaj ministrie, t’i përfundojnë, deri në datën 22 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen botimi i njoftimit të fituesit, lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë:
- Kite specifike dhe izotopi radioaktiv, me fond limit 2 000 000 lekë.
 - Citostatike, me fond limit 22 997 000 lekë.
 - Kite dhe reagentë. Fondi limit 19 317 240 lekë.
 - Rikonstruksioni i spitalit psikiatrik (punime shtesë, shtesë kontrate). Fondi limit 12 500 000 lekë pa TVSH.
 - Riparim i aparatit të endoskopisë në shërbimin e urologjisë, me fond limit 1 229 000 lekë.
 - Blerje aparaturash elektro-mjekësore për shërbimin e neurologji-neurokirurgjisë, me fond limit 21 666 668 lekë.
 - Materiale mjekësore për kardiokirurgjinë dhe kirurgjinë vaskulare.
 - Spitali rajonal Peshkopi:
 - Blerje materialesh të buta, me fond limit 2 600 000 lekë.
 - Shërbimi i rojeve private, me fond limit 900 000 lekë.
 - Blerje lëndësh djegëse për ngrohje solar, dhe dru zjarri, me fond limit 6 600 000 lekë.
 - Mirëmbajtje të objekteve ndërtimore, me fond limit 4 500 000 lekë.
 - Spitali rajonal Shkodër:
 - Blerje lëndësh djegëse për ngrohje, solar dhe dru zjarri, me fond limit 6 600 000 lekë.
 - Riparim dhe mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore.
 - Spitali rajonal Vlorë:
 - Blerje karburanti për ngrohje, me fond limit 3 355 451 lekë.
 - Drejtoria e Shëndetit Publik Kurbin:
 - Blerje solari, me fond limit 1 000 000 lekë.
 - Spitali universitar obsetrik gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë:
 - Blerje buke, me fond limit 400 312 lekë.
 - Mirëmbajtje të aparaturave mjekësore, me fond limit 3 300 000 lekë.
 - Blerje aparaturash mjekësore, me fond limit 20 358 330 lekë.
 - Spitali universitar obsetrik gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë:
 - F.V. pajisje mjekësore për maternitetin 2-Tiranë, me fond limit 48 920 400 lekë.
 - F.V. pajisje teknologjike për maternitetin 2-Tiranë, me fond limit 19 454 448 lekë.
 - Drejtoria e Shëndetit Publik Has:
 - Blerje pajisjesh hotelerie për spitalin Has.
 - Blerje karburanti për ngrohje.
 - Drejtoria e Shëndetit Publik e qarkut Dibër:
 - Blerje formular pacienti, me fond limit 499 500 lekë.
 - Blerje gazoil D2, me fond limit 680 833 lekë.
 - Drejtoria e Shëndetit Publik Krujë:
 - Blerje solari, me fond limit 600 000 lekë.
 - Mirëmbajtje aparaturash dhe pajisjesh mjekësore, me fond limit 500 000 lekë.

PROCEDURA TË PËRFUNDUARA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË (ORGAN QENDROR BLERËS) PËR BOTIM TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR NGA INSTITUCIONET

- Furnizimin e spitaleve me medikamente (metabolizmi, trakti tretës, organeve sensoriale etj.), fondi prej 86 653 209 lekësh.
- Furnizimin e spitaleve me medikamente (sistemi genito-urinar, hormonale, sistemi kardiovaskular, nervor etj.), me fond limit 84 437 839 lekësh.
- Furnizimin e spitaleve me medikamente (sistemi psikiatrik, anestezi-reanimacion, respirator, gjaku etj.), me fond limit 93 118 439 lekë.
- Furnizimin e spitaleve me medikamente (sistemi antiinfektiv, gjaku) me fond limit 92 278 502 lekë.
- Blerje medikamentesh për nevojat spitalore, të regjistruara për qarkullim në territorin e

Shqipërisë nga një kompani e vetme, me fond limit 489 080 200 lekë.

- Furnizimi i spitaleve me medikamente të ndryshme, me fond limit 85 766 400 lekë.
- Materiale konsumi (age bende sisteme), fondi limit 97 933 355 lekë.
- Materiale të ndryshme konsumi mjekësor (imazheri, ortopedi, desinfektantë). Fondi limit 66 722 233 lekë.
- Penjë qepës kirurgjikalë, me fond limit 80 051 750 lekë.
- Oksigjen i gaztë dhe protoksid azoti, me fond limit 35 154 900 lekë.
- Furnizimin e spitaleve me materiale konsumi mjekësor (anestezi, respiracion, drenazh, kirurgji dhe anestezi pediatrike), me fond limit 89 581 600 lekë.
- Furnizimin e spitaleve me materiale të buta, me fond limit 31 430 700 lekë.

VENDIM

Nr.1576, datë 17.10.2008

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me qendër në Tiranë, organizohet me qendra rajonale në Tiranë, Korçë, Fier dhe Lezhë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Rekrutimi i nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë bëhet sipas kushteve dhe kriterëve, të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Për punonjësit mbështetës zbatohet Kodi i Punës.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka për detyrë:

- ta zhvillojë dhe menaxhojë sistemin kombëtar të metrologjisë në Shqipëri, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe me nevojat kombëtare;

- t’i mbrojë interesat e konsumatorëve dhe të shtetit, nëpërmjet organizimit të kontrollit të mjeteve matëse, që përdoren për matje në transaksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mjedisin, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve;

- t’u ofrojë mundësi prodhuesve dhe përdoruesve për të garantuar saktësinë e mjeteve matëse, për të qenë konkurrues me prodhimet e tyre në tregun global.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të veta, ngre dhe administron laboratorë të ruajtjes së etaloneve kombëtare të matjeve, si dhe ato të kalibrimit e të verifikimit të instrumenteve matëse. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë i administrojnë këta laboratorë, sipas rregullave teknike dhe administrative, të përcaktuara.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë harton rregulloren e vet të funksionimit, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përkrahimi i vendit të punës të çdo hallke dhe të çdo funksioni, në veçanti.

6. Drejtori i përgjithshëm raporton, periodikisht, te ministri, që mbulon ekonominë.

7. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës miraton planin vjetor të punës, planin ekonomik-financiar të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe informohet sistematikisht për zbatimin e detyrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

8. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ndihmon, ndjek, monitoron dhe përgjigjet për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, para Këshillit të Ministrave.

9. Veprimtaria për krijimin, ruajtjen dhe transmetueshmërinë e etaloneve kombëtare të matjeve, e cila kryhet në laboratorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë apo jashtë saj, financohet nga Buxheti i Shtetit.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë bashkëpunon dhe shkëmben informacion me

strukturat e pushtetit vendor, bashkitë dhe komunat, për zbatimin e ligjshmërisë dhe ekzekutimin e gjobave ndaj subjekteve, që kanë kryer kundërvajtje administrative në fushën e metrologjisë.

11. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.

12. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1580, datë 3.12.2008

PËR MIRATIMIN E DISENJOS PËRFUNDIMTARE TË DOKUMENTEVE TË IDENTITETIT: LETËRNJOFTIMIT ELEKTRONIK DHE PASAPORTËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disenjës përfundimtare të dokumenteve të identitetit: letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës elektronike, sipas aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Çdo akt nënligjor, që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1581, datë 3.12.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “EURON” SHPK, “KADRIA” SHPK DHE “TEUTA KONSTRUKSION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “ORGJOST I RI”, “BELE 1”, “BELE 2”, “TOPOJAN 1” E “TOPOJAN 2”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe

bashkimit të shoqërive “Euron” sh.p.k., “Kadria” sh.p.k. dhe “Teuta Konstruktion” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Orgjost i ri”, “Bele 1”, “Bele 2” e “Topojan 1” e “Topojan 2”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1582, datë 26.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, BASHKITË, KOMUNAT DHE UJËSJELLËS SHA-TË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, të bashkive, komunave dhe ujësjiellës sh.a.-ve, t’i përfundojnë, deri në datën 31.12.2008, procedurat e prokurimit, për 53 objekte, me fondet buxhetore të investimeve, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve, Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë, komunat dhe ujësjiellës sh.a.-të, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE
OBJEKTE TË GRANDIT KONKURRUES

000/lekë

Nr.	Objekti i prokurimeve	Fondi i përgjithshëm	Autoriteti kontraktor	Data e zhvillimit të tenderit	Procedura e prokurimit	Data e lidhjes së kontratës
1	Ujësjiellësi i fshatit Lapardha 2	34,168	Komuna Otllak	02.10.2008	E hapur	04.11.2008
2	Rikonstruksion i rrjetit të ujësjiellësit të fshatit Shumbat, faza II	6,650	Komuna Sllovë	10.9.2008	E hapur	
3	Rikonstruksion ujësjiellësi fshati Vleshë, faza II	2,578	Komuna Sllovë	3.10.2008	E kufizuar	
4	KUZ në lagjet Bulku, Rexhep, Baromet, të fshatit Sallmone	23,074	Komuna Xhafzotaj	7.8.2008	E hapur	
5	Rikonstruksion i rrjetit dhe përmirësim i furnizimit me ujë për fshatrat Sukth, Erzen, Bisht-Kamëz dhe Katundi i Ri	6,474	Komuna Katundi i Ri	18.7.2008	E hapur	
6	Ndërtim ujësjiellësi i fshatit Budull	16,554	Komuna Bubq	11.8.2008	E hapur	
7	Ujësjiellës dhe KUZ i lagjes nr.10 dhe Magaza Fushë-Krujë	85,951	Bashkia Fushë-Krujë	31.7.2008	E hapur	
8	Ujësjiellësi i fshatit Sheze e Madhe	17,262	Komuna Shezë	22.10.2008	E hapur	
9	Projekti për burimin e ujit në tunelin e Qafë-Thanës	25,733	Komuna Rrajcë	22.9.2008	E hapur	10.11.2008
10	KUZ fshati Strume	44,663	Komuna Strumë	13.11.2008	E hapur	
11	KUZ në fshatin Ferras	25,889	Komuna Levan	21.11.2008	E hapur	
12	Rikonstruksioni i ujësjiellësit rajonal të Krahësit	15,441	Komuna Krahës	28.11.2008	E hapur	
13	Ujësjiellësi i fshatit Skore	7,799	Komuna Pogon	15.8.2008	E hapur	
14	Ujësjiellësi i fshatit Hudenisht (rrjeti i brendshëm)	22,691	Komuna Hudenisht	31.7.2008	E hapur	
15	Ujësjiellësi i fshatit Qinam (rrjeti i brendshëm)	17,082	Komuna Mollas	20.11.2008	E hapur	
16	Sistemimi i ujërave të bardha, fshati Çëravë	22,062	Komuna Çëravë	29.10.2008	E hapur	
17	Sistemim KUB në qendër Shënkoll dhe Rrilë kooperativë	5,684	Komuna Shënkoll	14.8.2008	E hapur	
18	Ndërtim ujësjiellësi Gruemirë-Çesme	17,842	SHA ujësjiellësi Malësi e Madhe	14.8.2008	E hapur	
19	Ujësjiellësi Krrabë-Fushë-Arrëz	39,254	Bashkia Fushë-Arrëz	18.8.2008	E hapur	

20	Rehabilitimi i ujësjellësit Hajmel	23,972	SHA ujësjellësi Fshat Shkodër	12.11.2008	E hapur	
21	Ujësjellësi Pezë Helmës (vazhdim) (për financim 4,500 000 lekë)	3,893	Komuna Pezë	16.10.2008	E kufizuar	
22	Rrjeti shpërndarës 8 fshatra ujësjellësi rajonal Baldushk	60,333	Komuna Baldushk	28.11.2008	E hapur	
23	Rikonstruksion i ujësjellësit rajonal Killojkë, linja kryesore nga burimi Vakuman deri fshati Pashkashesh	60,962	Komuna Bëzhitë	18.9.2008	E hapur	
24	Ujësjellësi Lagje e re	7,650	Komuna Ndroq	27.10.2008	E hapur	
25	Ujësjellësi Gjokaj	35,505	Bashkia Vorë	22.8.2008	E hapur	
26	Ujësjellësi rajonal i bashkisë Vorë, linja e transmetimit Vorë-Marikaj, faza e dytë	96,432	Bashkia Vorë	14.11.2008	E hapur	
27	Ndërtim linje ujësjellësi hyrje Kavajë-depo uji Kavajë L=3850m	35,684	SHA, ujësjellësi Kavajë	4.9.2008	E hapur	
28	Ndërtim KUZ i fshatit Kasallë	64,287	Komuna Zallherr	28.8.2008	E hapur	
29	Ujësjellësi Bashaj-Mesaplik	23,389	Komuna Brataj	12.12.2008	E hapur	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE
INVESTIME NË UJËSJELLËS KANALIZIME-OBJEKTE TË MËDHA

Nr.	Objekti i prokurimeve	Fondi limit i përgjithshëm	Data e zhvillimit të tenderit	Autoriteti kontraktor	Procedura e prokurimit	Shënime
1	Ujësjiellësi i Ksamilit, faza e II-të	219,195,000	2.10.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Vonesa, anulimi një herë i procedurës për shkak të mungesës së konkurrencës
2	Shtimi i sasisë së ujit dhe sistemimi i lidhjeve të abonentëve në linjën kryesore të ujësjiellësit: Stacioni i pompimit Fushë-Krujë-Vorë	28,755,833	31.10.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Vonesa, anulimi një herë i procedurës për shkak të mungesës së konkurrencës
3	Furnizimi me ujë i qytetit Pukë, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm	158,333,333	13.11.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Vonesa në kryerjen e oponencës së projektit
4	Furnizimi me ujë i zonës Kënetë, Durrës, zona 8-14	159,358,162	30.10.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Vonesa, anulimi një herë i procedurës për shkak të mungesës së konkurrencës
5	Rikonstruksion i ujësjiellësit të Rrjollit, Shkodër	123,198,680	13.10.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Vonesë në rishikimin e projektit pas vërejtjeve të këshillit teknik
6	Studim projektim për furnizimin me ujë të zonave të plazhit Durrës-Kavajë nga pus shpimet e Rrogozhinës	4,351,666	16.10.2008	DPUK	Shërbime konsulence	Është pritur që investimi për pusët studimore të jepte rezultat për sasinë dhe cilësinë e kërkuar me qëllim që të vazhdohej projektzbatimi
7	Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe të 14 fshtarave rreth tij	147,000,000	20.11.2008	Bashkia Kukës	Procedurë e hapur	Miratimi i ndryshimit të autoritetit kontraktor
8	Ujësjiellës-kanalizime Mamurras	81,740,000	2.12.2008	Bashkia Mamurras	Procedurë e hapur	Miratimi i ndryshimit të autoritetit kontraktor
9	Kanalizime Kodër Marlekaj, bashkia Lezhë	99,304,000	2.9.2008	Bashkia Lezhë	Procedurë e hapur	Miratimi i ndryshimit të autoritetit kontraktor
10	Rehabilitimi i linjës kryesore të rrjetit të qytetit Poliçan	12,284,166	14.11.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Objekt i financuar nga rialokimet pas problemeve të hasura në qytetin e Poliçanit

11	Studim fizibiliteti dhe projekte të detajuara për programin IPA 2007 të Komunitetit European në zonat bregdetare, vazhdim Loti 4 dhe 5	51,576,662	23.10.2008	DPUK	Shërbime Konsulence	Vonesa, anulimi një herë i procedurës për shkak të mungesës së konkurrencës
12	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës, stacioni i pompimit, Poshnjë, Berat	20,027,500	24.10.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Objekt i financuar nga rialokimet pas problemeve të hasura në qytetin e Urës Vajgurore
13	Ndërtim ujësjellësi i Urës Vajgurore dhe fshtrave përreth, punime me kaptazh	3,005,833	23.10.2008	DPUK	Procedurë e hapur	Objekt i financuar nga rialokimet pas problemeve të hasura në qytetin e Urës Vajgurore

VO. Fondet e mësipërme janë të llogaritura pa TVSH.

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE
OBJEKTE TË BUXHETIT SUPLEMENTAR

Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi limit i përgjithshëm	Autoriteti kontraktor	Data e zhvillimit të tenderit	Procedura e prokurimit	Shënime
-----	----------------------	----------------------------	-----------------------	-------------------------------	------------------------	---------

1	Rikonstrukcion rrjeti i brendshëm i ujësjellësit Cërrik, bashkia Cërrik, faza e II-të	67,585	Bashkia Cërrik	Në proces vlerësimi të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
2	Furnizimi me ujë i zonave rurale Malësi e Madhe, rrjeti shpërndarës, faza e II-të-6 fshatra	70,795	Komuna Kastrat, Shkodër	Në proces vlerësimi të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
3	Rikonstrukcion i linjës së ujësjellësit unazë, bashkia Durrës	31,359	SHA UK Durrës	17.11.2008	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
4	Rikonstrukcion ujësjellësi Delvinë (rrjeti i brendshëm)	61,632	Bashkia Delvinë	Në proces përgatitja e dokumenteve të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
5	Ndërtimi i linjës së ujësjellësit linjat 1,2,3 Sarandë	34,451	Bashkia Sarandë	13.11.2008	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
6	Rikonstrukcion ujësjellësi rajonal Tolar-Riban-Kuqan komuna Dishnicë, Përmet	7,500	Komuna Dishnicë Përmet	Në proces përgatitja e dokumenteve të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
7	Rikonstrukcion i ujësjellësit të fshatit Dukaj, komuna Qendër, Tepelenë	16,467	Komuna Qendër Tepelenë	Në proces vlerësimi të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
8	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën e banuar Sauk në rrugën e Plepave	15,118	SHA UK Tiranë	27.11.2008	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
9	Rrethimi i kaptazheve të ujësjellësit Shkodër	19,635	SHA UK Shkodër qytet	Në proces përgatitja e dokumenteve të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
10	Ndërtim KUZ fshati Prenjas, bashkia Prenjas	17,453	Bashkia Përrenjas	Në proces përgatitja e dokumenteve të tenderit	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar
11	Ujësjellësi i fshatrave Serrile, Bylysh, Mirine, kom Memaliaj	34,960	Komuna Memaliaj Tepelenë	21.11.2008	Procedurë e hapur	Financimi nga buxheti suplementar

VENDIM
Nr.1584, datë 3.12.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, PËR
OBJEKTET E INVESTIMEVE, TË GRANTIT KONKURRUES, NË SHËNDETËSI, PËR
VITIN 2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e njërive të qeverisjeve vendore, komuna/bashki, t’i përfundojnë procedurat e prokurimit, për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e objekteve të shërbimit parësor, me fondet e grantit konkurrues, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 31 dhjetor 2008.

Brenda këtij afati përfshihen edhe publikimi i fituesit dhe njoftimi, në Buletin e Njoftimeve Publike, i kontratës së nënshkruar, i ekzekutimit të punimeve të ndërtimit e i financimit të tyre.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
PROCEDURA QË ZHVILLOHEN NGA NJËSITË E QEVERISJEVE VENDORE

Vlera në lekë (me TVSH)

Kom. Otlak- BERAT	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Moravë Kom.Otlak
Kom. Qendër-SKRAPAR	2,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Buzuq dhe fsh.Orizaj Kom. Qendër
Kom. Potom-SKRAPAR	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Visockë Kom. Potom
Kom.Arras-DIBËR	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh. Grykë Noka Kom.Arras
Kom.Zall Dardhë-DIBËR	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Nezhaj Kom.Zall Dardhë
Kom. Kala e Dodës-DIBËR	2,500,000	Rikonstrukcioni i QSH ne Kom.Kala e Dodës
Kom. Sillovë-DIBËR	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh Dypjak Kom. Sillovë
Kom.Zerqan-BULQIZË	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Sofrocan Kom.Zerqan
Kom.Komsi-MAT	1,500,000	Rikonstrukcion i fsh në fsh. Zall-Shoshaj Kom.Komsi
Bashkia Klos-MAT	1,800,000	Ndërtim amb A1+çati fsh.Bel Bashkia Klos
Kom.Ishëm-DURRËS	1,930,000	Rikonstrukcion i QSH Kom.Ishëm
Bashkia Manëz-DURRËS	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Kameras bashkia Manëz
Bashkia Fushë-Krujë-KRUJË	1,540,000	Rikonstrukcion i poliklinikës bashkia Fushë-Krujë (faza II)
Kom. Pajovë-PEQIN	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Bishqem Fushë Kom.Pajovë
Kom. Pajovë-PEQIN	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Haspiraj Kom.Pajovë
Kom.Gjocaj-PEQIN	3,500,000	Rikonstrukcion i QSH Kom.Gjocaj
Kom.Skënderbegas GRAMSH	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh,Harunas Kom.Skënderbegas
Kom.Skënderbegas GRAMSH	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Bletës Kom.Skënderbegas
Kom. Libofsh-FIER	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Havaleas Kom.Libofsh
Kom.Qendër-FIER	1,200,000	Rikonstrukcion i QSH fsh Çlirim Kom.Qendër
Kom. Strumë-FIER	3,000,000	Ndërtim QSH T2 Kom.Strumë
Kom. Fier Shegan LUSHNJË	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Murriz Kozarë Kom. Fier Shegan
Kom. Fier Shegan LUSHNJË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Barbullinjë Kom. Fier Shegan
Kom. Allkaj- LUSHNJË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Delisufaj Kom.Allkaj
Kom. Allkaj- LUSHNJË	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Mazhaj Kom. Allkaj
Kom. Karbunarë-LUSHNJË	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Bicakaj Kom. Karbunarë

Kom. Karbunarë- LUSHNJË	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Skilaj Kom. Karbunarë
Kom. Hysgjokaj- LUSHNJË	3,000,000	Ndërtim qsh T2 fsh.Hysgjokaj Kom.Hysgjokaj
Kom. Qendër MALLAKASTËR	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh Visoke Kom.Qendër
Kom. Petran-PËRMET	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Gjinakar Kom.Petran
Kom.Pirg-KORÇË	3,500,000	Rikonstruksion QSH fsh.Pirg Kom.Pirg
Kom.Pirg-KORÇE	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Gurishte Kom. Pirg
Kom. Dardhas -POGRADEDEC	1,000,000	Rikonstruksion i QSH-së fsh.Osnate Kom. Dardhas
Kom. Çërravë- POGRADEDEC	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Alarup Kom. Çërravë
Kom. Çërravë - POGRADEDEC	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh. Lumas Kom. Çërravë
Kom. Shtiqen-KUKËS	700,000	Rikonstruksion i QSH Kom.Shtiqen
Kom.Fierzë-TROPOJË	1,000,000	Ndërtim çati për QSH fsh.Fierzë Kom. Fierzë
Bashkia Krumë-HASI	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Garjep bashkia Krumë
Kom. Shënkoll-LEZHË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Barbullonjë Kom. Shënkoll(ish-NB)
Kom Blinisht-LEZHË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Krajne Kom Blinisht
Kom. Blinisht-LEZHE	3,000,000	Ndërtim qsh T2 fsh.Blinisht Kom.Blinisht
Bashkia Rrëshen	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Fushë-Lumth Bashkia Rrëshen
Kom.Kthellë-MIRDITË	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Rushkull, Kom Kthellë
Kom.Kthellë-MIRDITË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Shebe Kom.Kthellë
Komuna Milot-LAÇI	1,500,000	Ndërtim amb A1 në fsh.Mal Milot kom.Milot
Kom.Bërdicë-SHKODËR	1,000,000	Rikonstruksion i QSH në Beltojë dhe Trush Kom.Bërdicë
Kom.Rrethinat-SHKODËR	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Guci e re Kom. rrethinat
Kom.Hajmel-SHKODËR	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Pistullë Kom.Hajmel
Kom.Hajmel-SHKODËR	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Nenshat Kom.Hajmel
Kom. Kelmend-MALËSI E MADHE	1,400,000	Ndërtim amb A2 + çati fsh.Nikc Kom. Kelmend
Kom. Gruemire- MALËSI E MADHE	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Omare Kom.Gruemire
Kom. Shkreh- MALËSI E MADHE	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Bzhate-Markaj Kom.Shkrel
Kom.Gjegjan- PUKË	2,400,000	Rikonstruksion i QSH Kom. Gjegjan
Bashkia Tiranë	3,000,000	Ndërtim QSH tip T2 Bregu i Lumit, njësia 11 Bashkia Tiranë
Kom. Paskuqan- TIRANË	2,000,000	Rikonstruksion i qendrës shënd, Paskuqan 1, Komuna Paskuqan
Kom. Paskuqan-TIRANË	1,000,000	Ndërtim amb A2, Kodër e kuqe, Komuna Paskuqan
Kom. Dajt- TIRANË	4,500,000	Ndërtim QSH T1+çati fsh Linzë (lagjia Qesarat) Kom.Dajt
Kom. Shëngjergj- TIRANË	2,500,000	Rikonstruksion i QSH fsh.Verri Kom.Shëngjergj
Bashkia Vorë- TIRANË	4,400,000	Rikonstruksion QSH në bashkinë Vorë
Bashkia Vorë- TIRANË	1,624,500	Rikonstruksion i ambulancave për fshatrat Gjokaj, Mucaj, Marikaj, Picar bashkia Vorë
Kom. Prezë- TIRANË	770,000	Rikonstruksion i QSH në Kom.Prezë
Kom.Kashar- TIRANË	2,000,000	Rikonstruksion QSH në fsh.Yzberisht, Komunën Kashar
Kom. Golem- KAVAJË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Kryemëdhënj Kom.Golem
Kom. Golem-KAVAJË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Qeret Kom.Golem
Kom. Kryevindh- KAVAJË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Spanesh Kom.Kryevindh
Kom. Lekaj- KAVAJË	1,000,000	Ndërtim ambulance A2 fsh.Mushnik Komuna Lekaj
Kom. Lekaj- KAVAJË	2,500,000	Rikonstruksion i QSH fsh.Luz i Madh Komuna Lekaj
Bashkia Vlorë	1,045,000	Rikonstruksion i QSH nr.3 bashkia Vlorë
Bashkia Oriku- VLORE	1,500,000	Ndërtim amb A1 plazhi Rradhimë Bashkia Oriku
Bashkia Himarë- VLORE	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh.Qeparo Fushë bashkia Himarë
Kom. Vergo- DELVINË	1,500,000	Ndërtim amb A1 fsh.Kalasë Kom.Vergo
Bashkia Delvinë	1,000,000	Ndërtim amb A2 fsh. Bamatat bashkia Delvinë
Kom.Ksamil-SARANDE	1,700,000	Rikonstruksion i QSH Kom. Ksamil

VENDIM
Nr.1586, datë 3.12.2008

**PËR TRANSFERIM FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, dhe të nenit 21 të ligjit nr.9620, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të bëhen:

a) rishpërndarja e fondit 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë, nga programi “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, zëri “Shpenzime kapitale të brendshme”, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Transferta korrente të brendshme”;

b) pakësimi i fondit 44 500 000 (dyzet e katër milionë e pesëqind mijë) lekë, nga programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Transferta korrente të brendshme”.

2. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta transferojë fondin 44 500 000 (dyzet e katër milionë e pesëqind mijë) lekë në llogarinë e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe të Industrisë së Shqipërisë.

3. Ky fond do të përdoret për organizimin nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe të Industrisë të Shqipërisë, gjatë vitit 2009, të një forumi ndërkombëtar, për promovimin e investimeve të huaja në Shqipëri.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.1587, datë 3.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1180, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR LEGALIZIM DHE MBLEDHJEN E ADMINISTRIMIT TË ARDHURAVE TË PROCESIT TË LEGALIZIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.4 Brenda një muaji nga pajisja me formularin e pagesës së tarifës së shërbimit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi, subjektet, që do të vazhdojnë procedurat e legalizimit të objekteve pa leje apo shtesave informale, në ndërtime me leje, do ta derdhin këtë pagesë në numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim nga ALUIZNI.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Subjektet, që kanë vetëdeklaruar jashtë afateve ligjore (në muajin e 3-të dhe të 4-t) të periudhës së vetëdeklarimit, së bashku me tarifën e shërbimit do t'i shlyejnë edhe sanksionet e parashikuara për këtë qëllim, për llogari të ALUIZNI-t, duke iu referuar kohës së vetëdeklarimit dhe natyrës së ndërtimit informal (vilë, shtesë familjare, shtesë tregtare), të parashikuara në nenin 8 të ligjit

nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Të ardhurat e mbledhura nga këto sanksione së bashku me tarifën e shërbimit, do të përdoren nga ALUIZNI, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 1.2 të këtij vendimi.”.

3. Pika 3.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.3 Taksa e ndikimit në infrastrukturë paguhet brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me formularin e pagesës, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi, për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet ndërtimi informal. Fondi i krijuar nga pagesa e kësaj takse, do të përdoret për financimin e studimeve urbanistike, realizimin e tyre dhe përmirësimin e infrastrukturës së territoreve, që legalizohen.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1588, datë 3.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA ALUIZNI, DREJTORIA QENDRORE DHE DREJTORIA RAJONALE E QARKUT TË SHKODRËS, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), drejtorisë qendrore dhe drejtorisë rajonale për qarkun Shkodër, të shtyjnë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, për mallra e ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 31 dhjetor 2008.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja dhe ekzekutimi i kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, drejtoria qendrore e drejtoria rajonale e qarkut të Shkodrës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

1. Autoriteti kontraktor: Drejtoria qendrore e ALUIZNI-t
Procedurë e hapur me objekt “Rikonstrukcion i disa ambienteve të zyrës qendrore të ALUIZNI-t”.

Loti I: Rikonstrukcion i godinës 1-katëshe.

Loti II: Rikonstrukcion i zyrës së titullarit.

Loti III: Montim grilash në fasadë dhe vendrojtë.

2. Autoriteti kontraktor: Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t për qarkun Shkodër

Procedurë e hapur me objekt “Blerje karburanti për vitin 2008”.

VENDIM
Nr.1591, datë 3.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1472, DATË 12.11.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PËR MINISTRINË E DREJTËSISË DHE INSTITUCIONET, NË VARËSI TË
SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.1472, datë 12.11.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe procedura e mëposhtme e prokurimit:

“- Furnizimi me ushqime për burgun e Peqinit, me fond limit 5 094 912 (pesë milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) lekë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1592, datë 3.12.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 6 dhjetor 2008, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 8 (tetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 11 dhjetor 2008, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 8 (tetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, të jetë pika e kalimit kufitar porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e

forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1595, datë 3.12.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1292, DATË 24.9.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË TË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE
GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas nënpikës xxxv të pikës 1 të vendimit nr.1292, datë 24.9.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet nënpika xxxvi, me këtë përmbajtje:

“xxxvi) ish-gjykatës së apelit ushtarak, Tiranë.”.

2. Bashkëlidhur vendimit në fuqi shtohet formulari, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR IVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Nr. rend.	A			B			C			
	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m²)	Nga sip. totale sa ndërtesë (m²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2	8150 TR – P - 13		Truall/ndërtesë	Gjykata e Apelit Ushtarak, Tiranë “Bul. Zhan D’Ark“	128	128	Zyra	Gjykata Apelit Ushtarak, Tiranë	Gjykata Apelit Ushtarak, Tiranë	Godina ka tre kate

VENDIM
Nr.1596, datë 26.11.2008

PËR KRYERJE PAGESASH, NË FORMË KONTRIBUTI, NË FONDIN E PËRBASHKËT TË NATO-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes të kryejë pagesën, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, në formë kontributi, në fondin e përbashkët të NATO-s, për të mbështetur ngritjen e forcës së sigurisë në Kosovë.

Pagesa të kryhet në llogarinë:

REF:	KFS Trust Fund
Bank:	FORTIS Bank
Account name:	SHAPE
Adress:	Montagne du parc 3 B-1000 Brussels, Blegium
IBAN account:	BE 25 2100 0010 0082
SWIFT/BIC:	GEBABEBB

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1599, datë 19.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË USHTARAKËVE, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PRANË NATO-S, NË SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008 për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Emërtimi	Paga në euro	Paga në USD	Shtesë përfaqësim
Përfaqësia e NATO-s			
Gj.Lejtant	1150	1390	75%
Gj.Major	1120	1340	60-75%
Gj.Brigade	1040	1250	60-75%
Përfaqësitë e tjera			
Kolonel	940	1140	40-60%
Nënkolonel	890	1080	40-60%
Major	840	1020	40%
Kapiten	780	990	40%
Toger	730	890	40%
Nëntoger	680	840	40%
K/kapter	730	890	40%
Kapter	650	780	40%
Rreshter	530	620	40%
Tetar	430	530	40%
Nëntetar	380	480	40%

VENDIM
Nr.1602, datë 10.12.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, NË PRONËSI TË 4 FAMILJEVE TË FSHTRAVE ZALL-MNER DHE BULÇESH, TË PREKURA NGA NDËRTIMI I UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, në pronësi të 4 familjeve të fshatrave Zall-Mner dhe Bulçesh, të prekura nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, për sipërfaqen 29 710 (njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e dhjetë) m², tokë arë, të vlerësuar me çmimin 626 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë/m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 18 598 460 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 235 000 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 18 598 460 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”, të parashikuar për shpronësimin e unazës Shkodër.

5. Procedurat e likuidimit të përfundojnë brenda datës 31.12.2008.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E 4 FAMILJEVE TË FSHATRAVE ZALL-MNER DHE BULÇESH,
TË CILAT KOMPENSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË UJËMBLEDHËSIT TË
BOVILLËS**

Nr.	Pronari			Sip. tokë arë	Çmimi	Vlera lekë	Fshati
	Emri	Atësia	Mbiemri				
1	Baftjar	Ramazan	Ademi	7360	626	4607360	ZALL-MNER
2	Ramazan	Asllan	Ruçi	5400	626	3380400	ZALL-MNER
3	Xhemal	Hider	Cali	10070	626	6303820	BULÇESH
4	Besim	Aruç	Hoxha	6880	626	4306880	BULÇESH
		TOTALI		29710		18598460	

VENDIM
Nr.1603, datë 10.12.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
GORË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gorë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gorë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.360, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Gorë të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

Komuna Gorë		
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
112-130	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
106-111	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
70-98	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi

44-69	Varrezat publike	Në pronësi
99-105	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
692-707,709-743	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
645-647,649,650,652,653,655,656,658,659,661,663,664,667,668,670,671,673,674,676,677,679,680,682,683,685,686,688,689	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
648,651,654,657,660,662,665,666,669,672,675,678,681,684,687	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
746-756	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
1-36	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1604, datë 10.12.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHETETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS MOGLICË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Moglicë, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Moglicë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.16, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Moglicë të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Moglicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Moglicë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
65	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
50-64	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
42-49	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
16-41	Varrezat publike	Në pronësi
1-15 (vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

1-15 (vetëm sheshet), 486-494	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
495-510	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
418-420,422-424,426-428,430-432,434-436,438,439,441-443,445,446,448-450,452-454,456,457,459-461,463,464,466,468-470,472-474,476-478,480-482	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
421,425,429,433,437,440,444,447,451,455,458,462,465,467,471,475,479,483	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.1609, datë 10.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE DHE DEGËN E DOGANËS, SHKODËR, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të degës së doganës, Shkodër, të përfundojnë, deri në datën 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për blerje, rikonstruksione e ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

ANEKSI I VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE Në lekë

Nr.	Emërtimi i projektit	Vlera
	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave	
1.	Blerje pajisjesh (link i licencuar DPD-Dajt për trasmetimin e të dhënave)	2,083,000
2.	Blerje automjesh	26,666,667
3.	Blerje kompjuterash dhe makina shumëfishimi për Këshillin e Ministrave	152,395,405
	Dega e doganës Shkodër	
1.	Shtrim-asfaltim i sheshit	3,432,946

2.	Rikonstrukcion i pikës doganore Bajzë	735,252
----	---------------------------------------	---------

VENDIM
Nr.1610, datë 10.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT TË FONDEVE BUXHETORE TË INVESTIMEVE, PËR DREJTORITË RAJONALE TË RRUGËVE, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e drejtorive rajonale të rrugëve të vazhdojnë prokurimin e fondeve buxhetore të investimeve për 13 objekte deri më 31.12.2008, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen botimi i njoftimit të fituesit, lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe drejtoritë rajonale të rrugëve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Drejtoria e Riparimit të Makinerive dhe Furnizimit Tiranë:

Procedura “Bojë vizimi dhe hollues” për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Elbasan:

-Procedura e furnizimit me karburant, për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate të nënshkruar.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Dibër:

-Ndërtim mur mbajtës masa inxhinierike Tyçep, për njoftim fituesi.

- Riparim ura e Muhurit, për njoftim kontrate.

Drejtoria e Riparimit të Makinerive dhe Furnizimit Tiranë:

-Procedura “Bojë vizimi dhe hollues” për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Elbasan:

-Procedura e furnizimit me karburant, për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate të nënshkruar.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Dibër:

-Ndërtim mur mbajtës masa inxhinierike Tyçep, për njoftim fituesi.

-Riparim Ura e Murit, për njoftim kontrate.

-Pastrim bore dhe shembje (mirëmbajtje dimërore) për njoftim fituesi.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Kukës:

-Ndërtim mur mbajtës Kukës-Shishtavec, km 11.5, për njoftim fituesi dhe njoftimi i kontratës së nënshkruar.

-Sistemim asfaltim rruga Kukës-Has, km 1 shtesë punimesh, për njoftim kontrate.

-Masa mbrojtëse ura e lumit Krumë, km.30.3, njoftim kontrate.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Korçë:

-Mirëmbajtje dhe performancë rutinë dimërore Pllocë-Pogradec-D.Tushemisht, njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së lidhur.

-Riparim parmakë metalikë, njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së lidhur.

-Riparim ura e Kovaçit, njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së lidhur.

-Mirëmbajtje dimërore me performancë Korçë-Dardhë vetëm për sezonin e dimrit 2008-2009 me afat 6-mujor, për njoftim fituesi dhe njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Durrës:

-Shtirim me çakull km 20-24 Qafë Shtamë, për njoftim fituesi dhe njoftim i kontratës së nënshkruar.

-Pastrim bore dhe shembje (mirëmbajtje dimërore) për njoftim fituesi.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Kukës:

-Ndërtim mur mbajtës Kukës-Shishtavec km 11.5, për njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së nënshkruar.

-Sistemim asfaltim rruga Kukës-Has, km 1 shtesë punimesh, për njoftim kontrate.

-Masa mbrojtëse ura e lumit Krume, km 30.3, njoftim kontrate

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Korçë:

-Mirëmbajtje dhe performancë rutinë dimërore Pllocë-Pogradec-D.Tushemisht, njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së lidhur.

-Riparim parmakë metalikë, njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së lidhur.

Riparim Ura e Kovaçit, njoftim fituesi dhe njoftim të kontratës së lidhur.

-Mirëmbajtje dimërore me performancë Korçë-Dardhë vetëm për sezonin e dimrit 2008-2009 me afat 6-mujor, për njoftim fituesi dhe njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Durrës:

-Shtirim me çakull km 20-24 Qafë Shtamë, për njoftim fituesi dhe njoftim i kontratës së nënshkruar.

VENDIM

Nr.1611, datë 10.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA AKADEMIA E SHKENCAVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Akademisë së Shkencave t’i përfundojë procedurat e prokurimit, për botimin e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2008, brenda datës 31 dhjetor 2008.

Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1612, datë 10.10.2008

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2007, PËR PROJEKTIN “SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA, KORÇA IV”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2007, për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korça IV”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR, 2007
(SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA, KORÇË IV)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 16 tetor 2007,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër që do të zgjidhet bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau (KfW) një hua të kombinuar, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik në fushën e zhvillimit, me vlefë prej deri në 15.000.000 euro (me fjalë: pesëmbëdhjetë milionë euro) për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korçë IV”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se – duke gjykuar nga aspekti i politikës së zhvillimit – projekti vlen për t'u mbështetur, kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë mjaft e besuar për kredi, dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rast se ai vetë nuk do të jetë kredimarrës, jep një garanci shtetërore. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau hua të tjera ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 2 do të kthehen në hua, në rast se nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditansalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftehet, në rast se kontratat përkatëse për marrjen e huasë dhe për financimin nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2015.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditansalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit t'i zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huasë dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 7.10.2008, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.1613, datë 10.12.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, ME KOHË TË PLOTË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në Fakultetin e Edukimit, si më poshtë vijon:

- a) Në lëndën "Gjuhë angleze";
- b) Në lëndën "Gjuhë italiane".

Në përfundim të këtyre programeve lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP) në mësuesi", për ciklin e lartë të arsimit bazë.

2. Programi i studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.

3. Kuota e pranimeve në këto programe studimi, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më

poshtë vijon:

i) Në lëndën “Gjuhë angleze”, 120;

ii) Në lëndën “Gjuhë italiane”, 120.

4. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në këtë universitet. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, përcaktuar nga njësitë kryesore të universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, bëhen publike paraprkisht.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas nënndarjes “ii” të shkronjës “a” të pikës 7 të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

6. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbrit, të shurdhët, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë, që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, master i nivelit të parë në mësuesi, në institucionet publike të arsimit të lartë, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Studentët e shkëlqyer nuk paguajnë, në çdo program studimi, master i nivelit të parë në mësuesi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

9. Kuotat e pranimeve në këto programe, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1614, datë 10.12.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË KATËR AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 10 dhjetor 2008, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 10 (dhjetë) automjete dhe 23 (njëzet e tre) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 11 dhjetor 2008, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tri) automjete dhe 4 (katër) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 12 dhjetor 2008, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 7 (shtatë) trupa.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 13 dhjetor 2008, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 26 (njëzet e gjashtë) trupa.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 10 e 11 dhjetor 2008, të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat që do të kalojnë në datat 12 e 13 dhjetor 2008, të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

6. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

7. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1615, datë 10.12.2008

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË DREJTËSISË, TË OBJEKTIT “SHTËPIA E USHTARAKËVE, POGRADEK, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Drejtësisë, të objektit “Shtëpia e ushtarakëve, Pogradec”, me sipërfaqe 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) m², me numër rendor 23 (faqe 130), në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2. Ky objekt të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i

bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Bashkia/komuna:

Fusha e përdorimit të pronës:

[illegible]

VENDIM
Nr.1616, datë 10.12.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË
KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E MASAVE PËR IMPORTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 5, e 26 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”, dhe të nenit 25 të ligjit nr.9796, datë 23.7.2007 “Për masat antidumping dhe kundërbalancuese”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullore së organizimit dhe të funksionimit të komisionit për vlerësimin e masave për importet, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E MASAVE
PËR IMPORTET**

1. Objekti dhe fusha e veprimit përcaktohen si më poshtë:

1.1 Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave, rregullave dhe i përgjegjësiave dhe funksionimit të Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet (që në vazhdim të kësaj rregulloreje do të quhet Komisioni), për marrjen e masave antidumping, kundërbalancuese dhe masave mbrojtëse në importe”, të përcaktuara në ligjin nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”, neni 4, pika 5, dhe neni 26 dhe ligjin nr.9796, datë 23.7.2007 “Për masat antidumping dhe kundërbalancuese”, neni 25.

1.2 Kjo rregullore zbatohet nga Komisioni dhe sekretariati teknik i këtij Komisioni.

2. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit

2.1 Për shqyrtimin e masave antidumping, të masave kundërbalancuese, si dhe masave mbrojtëse për importet, në zbatim të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe” dhe të ligjit nr.9796, datë 23.7.2007 “Për masat antidumping dhe kundërbalancuese”, është krijuar organi kolegjal shtetëror “Komisioni për vlerësimin e masave për importet”.

2.2 Struktura përgjegjëse për antidumpingun dhe masat mbrojtëse në importe, pranë ministrisë që mbulon tregtinë, ushtron funksionet e sekretariatit teknik, gjatë gjithë procesit të hetimit dhe punës së Komisionit.

2.3 Komisioni ushtron veprimtari në përputhje me këtë rregullore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret në këtë fushë.

2.4 Anëtarët e komisionit në mbledhjen e tij të parë duhet të nënshkruajnë një deklaratë, për paanësinë e tyre në ushtrimin e këtij funksioni.

3. Kompetencat e këtij Komisioni janë:

a) miraton ose refuzon kërkesën që bëjnë subjektet e interesuara për fillimin e hetimit, zgjatjen e periudhës së hetimit apo pezullimin e tij në rast të tërheqjes së aplikimit gjatë hetimit;

b) kryen seanca dëgjimore me palët e interesuara përpara marrjes së vendimit përfundimtar të hetimit;

c) vendos ose jo për marrjen e masave të përkohshme;

d) vendos, në përfundim të hetimit, për marrjen ose jo të masave përfundimtare;

e) vendos për zgjatjen e periudhës së zbatimit të masave të përkohshme dhe të masave përfundimtare;

f) merr vendime të tjera, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe” dhe ligjit nr.9796, datë 23.7.2007 “Për masat antidumping dhe

kundërbalancuese”;

g) nxjerr udhëzime, në zbatim të këtyre ligjeve të sipërpërmendura;
h) vendos për thirrjen e ekspertëve dhe specialistëve për t’u dëgjuar në Komision;
i) harton rregullat e aplikimit dhe të procedurave të masave mbrojtëse, masave antidumping dhe kundërbalancuese;

j) miraton modelet e formularëve, që duhet të plotësohen nga subjekte të cilat janë palë në procesin e hetimit.

4. Kryetari i Komisionit kryen këto detyra:

- a) drejton mbledhjet e komisionit;
- b) vendos për rendin e ditës dhe datën e mbledhjes së komisionit;
- c) organizon konsulta paraprake me anëtarët e komisionit;
- d) ngarkon me detyra të veçanta anëtarët në kuadër të zbatimit të vendimeve;
- e) thërret në takime të veçanta anëtarët për t’u informuar për ecurinë e punëve;
- f) nënshkruan vendimet e Komisionit.

5. Në mbledhje anëtarët e Komisionit janë të barabartë. Anëtari ka të drejtë:

- a) të bëjë pyetje kundrejt palëve, ekspertëve në interes të çështjes në hetim;
- b) të kërkojë sqarime për materialet e paraqitura;
- c) të ngrejë probleme në interes të punës së Komisionit;
- d) sugjeron rend dite për mbledhjet e Komisionit;
- e) merr përsipër detyrimet e institucionit që përfaqëson për problemet përkatëse të veprimtarisë së Komisionit.

6. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës. Në rast nevojë, ai mund të thërrasë dhe mbledhje të jashtëzakonshme të Komisionit.

7. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet. Bashkëlidhur lajmërimit duhet të jetë rendi i ditës, që duhet t’u shpërndahet të gjithë anëtarëve, 7 (shtatë) ditë pune përpara zhvillimit të saj.

8. Si rregull, raportet hetimore, të përgatitura nga sekretariati teknik, duhet t’u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve të Komisionit, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara zhvillimit të mbledhjes.

9. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme, kur janë të pranishëm jo më pak se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të tij. Në fillim të mbledhjes, kryetari i Komisionit verifikon numrin e pjesëmarrësve dhe në mungesë të shumicës së nevojshme, vendos thirrjen e mbledhjes tjetër jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga mbledhja paraardhëse. Listëprezenca hartohet nga sekretariati teknik dhe nënshkruhet nga kryetari i Komisionit.

10. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve sipas rendit të ditës, kryetari i Komisionit vendos hedhjen në votë të çështjeve për të cilat duhet të merren vendim nga Komisionit. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave (shumicë absolute). Në rast barazie votash, vendos vota e kryetarit të Komisionit.

11. Në rast se kryetari i Komisionit mungon apo është në pamundësi për t’i ushtruar kompetencat për drejtimin e Komisionit, mbledhjet do të drejtohen nga anëtari me pozitën më të lartë hierarkike, në përputhje me nenin 5 pika 3 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”.

12. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe vetëm në raste të veçanta mund të merret vendim që ato të bëhen publike. Për çdo mbledhje mbahet procesverbali, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe sekretariati teknik.

13. Vendimet e Komisionit për vlerësimin e masave për importet, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha palët e përfshira në procesin e hetimit, si dhe strukturat dhe personat e ngarkuar prej tij.

14. Qëndrimet publike të kryetarit, anëtarëve të tjerë të Komisionit për çështjet konkrete në shqyrtim, si rregull, konsultohen edhe/ose diskutohen paraprakisht në mbledhjet e Komisionit.

15. Sekretariati teknik kryen detyrat e mëposhtme:

- a) organizon dhe drejton veprimtarinë për përgatitjen me nivel të mbledhjeve;
- b) bën shqyrtimin e të dhënave të paraqitura në aplikim dhe ia paraqet Komisionit për vlerësim, duke qenë se është pjesë e rëndësishme e gjithë procesit të hetimit;
- c) bën njoftimin e anëtarëve dhe të të ftuarve në mbledhje;

d) shpërndan rendin e ditës dhe materialet e përgatitura;
e) kujdeset për përgatitjen e projektvendimeve, raporteve që do të paraqiten për miratim në Komision;

f) koordinon punën me institucionet që janë ngarkuar me problemet që do të diskutohen në lidhje me çështjet nën shqyrtim, për përgatitjen në kohë të materialeve për mbledhjen e komisionit dhe për zbatimin e vendimeve të marra;

g) ruan dhe administron dokumentacionin mbi veprimtarinë e këtij komisioni.

17. Sekretariati teknik ka për detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve dhe përgatitjen e materialeve që shqyrtohen në mbledhjen e Komisionit, si dhe mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjes.

18. Sekretariati teknik kujdeset dhe përgjigjet për dërgimin dhe marrjen e të dhënave, njofton për fillimin e hetimit shtetet, produktet e të cilave janë objekt i hetimit dhe palët e interesuara që kanë interesa, si eksportuesit, importuesit dhe shoqatat përfaqësuese të importuesve ose eksportuesve të interesuar, si dhe vendin e origjinës dhe/ose eksportues e paditësit. Sekretariati teknik bën një njoftimin publik në Fletoren Zyrtare dhe në një gazetë me përhapje të gjerë në Republikën e Shqipërisë.

19. Me fillimin e hetimeve, sekretariati teknik i dërgon pyetësorë çdo personi, që beson se mund të ketë të dhëna të vlefshme për hetimin, duke përfshirë prodhues të njohur vendas, importues, eksportues, prodhues të huaj dhe qeverive të vendeve, produktet e të cilave janë objekt hetimi.

20. Sekretariati teknik ka të drejtë të kryejë çdo ditë veprime, pa kaluar në Komision, për rastet e shënuara më poshtë, mbështetur në dokumentacionin përkatës të paraqitur në zbatim të kësaj rregulloreje. Sekretariati teknik komunikon me subjektet kërkuese:

- a) për plotësim dokumentacioni sipas kërkesave të ligjit;
- b) për dhënie informacioni, pranim dokumentesh, faturash doganore dhe për sqarime të tjera;
- c) për shpjegimin e legjislacionit subjekteve të interesuara.

21. Në Komisionin për vlerësimin e masave për importet mbahet një regjistër i përgjithshëm për regjistrimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e korrespondencës.

22. Korrespondenca e regjistruar vendoset në dosje dhe arkivohet në arkivën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

23. Kërkesa për fillimin e hetimit dhe dokumentacioni përkatës bashkëngjitur, ankesat dhe materiale të tjera që i adresohen Komisionit i dërgohen zyrtarisht të protokolluara nga subjektet dhe të mbyllura në zarfin përkatës. Në faqen e jashtme të zarfit që mban adresën e plotë të subjektit kërkuar, nënshkrimin dhe vulën e tij, të shkruhet adresa e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me shënimin drejtuar Komisionit për vlerësimin e masave për importet.

24. Kërkesa e protokolluar, pasi konsiderohet nga kryetari i Komisionit, i adresohet sekretariatit teknik, i cili për çdo subjekt hap një dosje të veçantë dhe e ruan atë për të paktën një vit kalendarik, pastaj e dorëzon në arkivën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

25. Çdo kërkesë e ardhur:

a) shoqërohet detyrimisht me relacion shpjegues, i cili përgatitet nga sekretariati teknik;
b) i paraqitet Komisionit për shqyrtim nëse ajo është në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

26. Në rastet kur një anëtar i Komisionit, sipas legjislacionit në fuqi, ka konflikte interesash, në lidhje me çështjen që shqyrtohet, ai duhet të lajmërojë menjëherë kryetarin e Komisionit.

27. Kryetari merr vendimin për përjashtimin nga votimi të anëtarit të Komisionit. Kur kërkesa për përjashtimin e një anëtari të Komisionit nga votimi bëhet jo nga vetë anëtari, por nga një palë e interesuar, kryetari e merr vendimin për përjashtimin ose jo, pas një hetimi të gjithanshëm dhe pasi dëgjon edhe argumentet e anëtarit që dyshohet se ka konflikt interesash. Në rastet kur vetë kryetari preket ose dyshohet se preket nga një pengesë ligjore, vendimin për përjashtimin ose mospërjashtimin e tij nga votimi e merr vetë Komisioni.

28. Në çdo rast, vendimi për përjashtimin ose jo nga votimi të një anëtari apo të kryetarit të Komisionit merret brenda 5 ditë pune nga dita kur vetë anëtari deklaron pengesën ose kur pala e interesuar bën kërkesën.

29. Anëtarët e Komisionit që kanë konflikt interesash, nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe gjatë votimit.

30. Të gjitha vendimet e Komisionit nuk duhet të bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit

nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Komisioni bashkëpunon dhe kërkon vlerësimet nga Autoriteti i Konkurrencës në çdo rast që e gjykon të nevojshme në interes të çështjes në hetim.

31. Në kreun e shkresave zyrtare shkruhet simboli: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” dhe poshtë saj emërtimi i plotë: “KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E MASAVE PËR IMPORTET”.

32. Vula zyrtare e Komisionit përmban shkrimin me shkronja kapitale si më poshtë:
“REPUBLIKA E SHQIPËRISË”.

“KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E MASAVE PËR IMPORTET”. Vula do të ruhet pranë zyrës së protokollit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

33. Ekspertët shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhje, me vendim të Komisionit, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

VENDIM **Nr.1674, datë 24.12.2008**

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË, PËR MAKINERITË DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGJINË ELEKTRIKE, TË IMPORTUAR NGA KESH-SHA-JA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të seksionit I “Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për importimin e makinerive e të pajisjeve” të vendimit nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të shtohet seksioni I/I, me këtë përmbajtje :

“I/I. Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për importin e makinerive e të pajisjeve, kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimi i ofrimit të prodhimit apo shërbimit është mbi 12 muaj.

1. Për makineritë e pajisjet e importuara, të përcaktuara në aneksin, që i bashkëlidhet këtij vendimi, cikli i zhvillimit të investimeve të cilave dhe i fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit, është mbi dymbëdhjetë muaj, bëhet zgjatja e afatit të pagesës së TVSH-së, që lidhet me importimin e makinerive e të pajisjeve, përtej dymbëdhjetë muajve, nga çasti i kryerjes së importit.

Personat e tatueshëm importues, që të jenë përfitues të shtyrjes së pagesës së TVSH-së, duhet që importin e makinerive e të pajisjeve ta destinonjë për investim, në kuadër të veprimtarisë së tyre dhe jo për shitje të tretët.

Prodhimi apo shërbimi, për të cilin bëhet investimi, përftohet përtej periudhës dymbëdhjetëmujore, nga muaji i kryerjes së importit të makinerive e të pajisjeve, lidhur me atë investim.

2. Personi i tatueshëm, përfitues i kësaj skeme, në çastin e importit, paraqet në organin doganor, dokumentacionin e nevojshëm justifikues, shoqëruar të makinerive e të pajisjeve të importuara, në bazë të kërkesave të legjislacionit doganor. Vlera e tatueshme e makinerive dhe e pajisjeve të importuara përcaktohet, në përputhje me dispozitat e legjislacionit doganor dhe tatimor, pavarësisht nëse këto makineri dhe pajisje janë apo jo të taksueshme me taksa doganore. Kjo vlerë përfshin, gjithashtu,;

a) shpenzimet e transportit e të sigurimit dhe shpenzimet e tjera, të përfshira në importimin e makinerive e të pajisjeve, deri në çastin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) tarifatat, taksat dhe detyrimet e pagueshme, si pasojë e eksportimit të këtyre makinerive e pajisjeve nga shtete, prej të cilave ato eksportohen, apo të pagueshme, si rezultat i importimit të tyre, përveç TVSH-së së pagueshme.

Organi doganor, pasi përcakton vlerën e tatueshme të makinerive dhe të pajisjeve, me të gjitha elementet e saj, zbaton mbi këtë vlerë, shkallën tatimore të TVSH-së, e cila është në fuqi, në çastin e importimit të makinerive e të pajisjeve.

TVSH-ja e llogaritur nga organi doganor nuk paguhet nga personi i tatueshëm, në çastin e zhdoganimit të makinerive e të pajisjeve të importuara.

Organi doganor i lëshon personit të tatueshëm importues deklaratën doganore, sipas së cilës zbatohet pagesa e shtyrë e TVSH-së.

3. Në muajin e dymbëdhjetë, pas periudhës së importit, personi i tatueshëm paraqet një kërkesë me shkrim në drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar, me të cilën kërkon zbatimin e procedurës së shtyrjes së pagesës së TVSH-së, përtej periudhës dymbëdhjetëmuajore.

4. Mungesa e kërkesës apo e interesimit të personit të tatueshëm, brenda muajit të dymbëdhjetë, i humb atij të drejtën e përfitimit nga kjo skemë dhe, që nga muaji i trembëdhjetë, ai vlerësohet si debitor ndaj organit doganor.

5. Drejtoria rajonale tatimore verifikon menjëherë përputhjen e kërkesës së personit të tatueshëm me rrjedhojën e kryerjes së investimeve. Konkretisht, ajo verifikon faktin që personi i tatueshëm nuk ka kryer:

- a) asnjë furnizim për të tretë;
- b) vetëfurnizim;
- c) përdorim për vete të produktit, për të cilin kryhet investimi.

Drejtorja rajonale tatimore mban në një regjistër të veçantë të dhëna për çdo person të tatueshëm, që përfiton nga shtyrja, përtej dymbëdhjetë muajve e pagesës së TVSH-së.

Kjo kategori personash të tatueshëm mbikëqyret nga kjo drejtori, deri në kryerjen e furnizimit të parë, të paraqitur në faturën tatimore, të lëshuar prej tij.

6. Kur vërtetohet, pas verifikimit në vend, përputhja e kërkesës së personit të tatueshëm me situatën në fakt, drejtoria rajonale tatimore dërgon, zyrtarisht, brenda 7 ditëve nga data e protokollimit të kërkesës, në adresë të personit të tatueshëm, konfirmimin e faktit që produkti/shërbimi, për të cilin kryhet investimi, nuk është krijuar dhe as nuk është furnizuar nga personi i tatueshëm. Në të njëjtën shkresë zyrtare paraqitet edhe situata tatimore e personit të tatueshëm, për pagesën e detyrimeve të aplikuara tatimore, si dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

7. Personi i tatueshëm i paraqet Ministrit të Financave kërkesën, me shkrim, për shtyrjen e afatit të pagesës së TVSH-së, përtej dymbëdhjetë muajve, së bashku me :

- a) përgjigjen e dhënë nga drejtoria rajonale tatimore (origjinale), sipas pikës 6 të këtij seksioni;
- b) kopjen e kontratës/ave ose të marrëveshjes me zbatuesit e investimit, ku të jetë përcaktuar qartë afati i kryerjes së të gjithë ciklit të investimeve;
- c) parashikimin e afatit të fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit.

8. Ministri i Financave, brenda shtatë ditëve nga data e protokollimit të kërkesës, miraton ose jo zgjatjen e afatit të shtyrjes së pagesës së TVSH-së për subjektin e interesuar. Një kopje e kërkesës së miratuar dërgohet pranë autoritetit doganor, me qëllim që subjekti të mos shpallet debitor.

9. Personi i tatueshëm, në të njëjtin muaj, që përputhet me periudhën, kur ai do të kryejë furnizimin e parë të produktit të përfutur nga investimi i kryer, paraqitet në drejtorinë rajonale doganore, ku janë kryer procedurat e importit, për të kryer pagesën e TVSH-së, të llogaritur në çastin e importit. Për pagesën e kryer, drejtoria rajonale doganore i lëshon personit të tatueshëm dokumentin përkatës, për këtë veprim.

Njëkohësisht, drejtoria doganore njofton, me shkrim, drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar personi i tatueshëm, për mbylljen e veprimeve të lidhura me TVSH-në, me këtë person.

10. Drejtoria rajonale tatimore, me të marrë njoftimin nga drejtoria rajonale doganore, për pagesën e TVSH-së, bën shënimet e saj përmbysë me personin e tatueshëm, në regjistrin e veçantë, të mbajtur për këtë kategori.

11. Data e pagesës së TVSH-së në doganë përcakton edhe periudhën tatimore (muajin), në të cilin personi i tatueshëm e regjistron (vetëm për qëllim të mbajtjes së dokumentacionit për TVSH) dhe e deklaron TVSH-në, si të zbritshme pranë organeve tatimore.

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së të kësaj periudhe tatimore, vlera e tatueshme e makinerive dhe e pajisjeve, si dhe TVSH-ja, e llogaritur dhe e paguar për importin e tyre, raportohen, përkatësisht, në rubrikat e importit.

12. Personi i tatueshëm gëzon të drejtën e kreditimit të plotë të TVSH-së, vetëm kur makineritë dhe pajisjet e importuara i shërbejnë krejtësisht veprimtarisë së tij të tatueshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e

Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1695, datë 24.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.338, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në “Modelin e tregut të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e katërt të pikës 4.2 “Gjenerimi (KESH Gen)”, pas shprehjes “Shet energji...” të hiqet fjala “të tepërt”.

b) Në paragrafin e fundit të shkronjës “A” të pikës 4.13 “Marrëdhëniet mes pjesëmarrësve të tregut”, pas shprehjes “...marrëveshje tip...” të hiqet shprehja “...ose rregulla prokurimi...”

c) Fjalja e parë, e paragrafit të dytë të pikës 5.7 “Shitjet e KESH Gen-it, tek blerës të tjerë”, pas shprehjes “...energji elektrike...” të hiqet fjala të tepërt”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.1.2009
Doli nga shtypi më 7.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 42 lekë